<p style="text-align: center;"><b>Neni 39</b> <b>Qëllimi dhe shqiptimi i masave të trajtimit të detyrueshëm</b></p> <p>1. Qëllimi i masës së trajtimit të detyrueshëm është që të kontribuojë në rehabilitimin e të miturit dhe të parandalojë rrezikun nga recidivizmi. Trajtimi i detyrueshëm shqiptohet në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Gjykata mund të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ndaj të miturit në pajtim me Kapitullin V të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Gjykata mund të shqiptojë masën për trajtim të detyrueshëm të rehabilitimit ndaj të miturit në pajtim me kapitullin V të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.</p> <p>4. Masa për trajtim të detyrueshëm shqiptohet vetëm pas konsultimit me shërbimin sprovues, organin e kujdestarisë dhe ekspertët përkatës.</p> <p>5. Masa e trajtimit të detyrueshëm nuk mund të shqiptohet në të njëjtën kohë</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 39</b> <b>Purpose and Imposition of Measures of Mandatory Treatment</b></p> <p>1. The purpose of a measure of mandatory treatment is to contribute to the rehabilitation of the juvenile and to prevent the risk of recidivism. The mandatory treatment shall be imposed in accordance with the provisions of Criminal Code of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The court may impose a measure of mandatory psychiatric treatment on a juvenile in accordance with the Chapter V of Criminal Code of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. The court may impose a measure of mandatory rehabilitation treatment on a juvenile in accordance with Chapter V of the Criminal Code of the Republic of Kosovo.</p> <p>4. A measure of mandatory treatment shall be imposed only after consultation with the Probation Service, the Guardianship Authority and appropriate experts.</p> <p>5. A measure of mandatory treatment cannot be imposed simultaneously with a</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 39</b> <b>Svrha i izricanje mera obaveznog lečenja</b></p> <p>1. Svrha mere obaveznog lečenja je da doprinese rehabilitaciji maloletnika i sprečavanju rizika od recidivizma. Obavezno lečenje se izriče u skladu sa odredbama Krivičnog zakonika Republike Kosovo.</p> <p>2. Sud može da izrekne meru obaveznog psihijatrijskog lečenja maloletniku u skladu sa Poglavljem V iz Krivičnog zakonika Republike Kosovo.</p> <p>3. Sud može da izrekne meru obaveznog psihijatrijskog lečenja maloletniku u skladu s Poglavljem V iz Krivičnog zakonika Republike Kosovo.</p> <p>4. Mera obaveznog lečenja izriče se samo posle odgovarajućih konsultacija sa Pobacionom Službom, Organom starateljstva i odgovarajućim stručnjacima.</p> <p>5. Mera obaveznog lečenja ne može da bude izrečena istovremeno sa sudskim ukorom.</p>

<p>me qortimin gjyqësor .</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 40</b> <b>Shqiptimi i dënimit plotësues</b></p> <p>1. Kur gjykata e konsideron të arsyeshme mund të shqiptojë dënimin plotësues në pajtim më nenin 64 dhe 69 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Dënimet plotësuese sipas nenit 62 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, mund t'i shqiptohen madhorit të ri kur gjykohet sipas nenit 16 të këtij Kodi.</p>	<p>judicial admonition.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 40</b> <b>Imposition of Accessory Punishments</b></p> <p>1. When the court finds it justifiable it may impose accessory punishment in accordance with the Article 64 and 69 of Criminal Code of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Accessory punishments may, pursuant to Article 62 of Criminal Code of the Republic of Kosovo, be imposed to young adult when judged based on Article 16 of the present Code.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 40</b> <b>Izricanje dopunske kazne</b></p> <p>1. Kada sud smatra opravdanim može da izrekne i dopunsku kaznu u skladu sa članom 64 i 69 iz Krivičnog zakonika Republike Kosovo.</p> <p>2. Dopunske kazne na osnovu člana 62 iz Krivičnog zakonika Republike Kosovo, mogu da se izreknu mladom punoletnom licu kada mu se sudi na osnovu člana 16 iz ovog Zakonika.</p>
<p style="text-align: center;"><b>PJESA E TRETË</b> <b>KAPITULLI I - PROCEDURA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 41</b> <b>Veprimet urgjente dhe ndalimi i gjykimit në mungesë</b></p> <p>1. Kur i mituri është në mbajtje, arrest apo paraburgim, organet të cilat e zhvillojnë procedurën detyrohen të veprojnë me urgjencë.</p> <p>2. I mituri nuk mund të gjykohet në mungesë.</p> <p>3. Kur ndërmarrin ndonjë veprim në të cilin është i pranishëm i mituri dhe sidomos gjatë marrjes së tij në pyetje, organet që</p>	<p style="text-align: center;"><b>THIRD PART</b> <b>CHAPTER I -PROCEEDINGS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 41</b> <b>Urgent Actions and Prohibition of Adjudication in Absentia</b></p> <p>1. When a juvenile is in detention, arrest or remand, the authorities that carry out the proceedings shall be obliged to act with urgency.</p> <p>2. A juvenile shall not be adjudicated in absentia.</p> <p>3. When undertaking an action at which a juvenile is present, and especially at his examination, the authorities participating</p>	<p style="text-align: center;"><b>TREĆI DEO</b> <b>POGLAVLJE I - POSTUPAK</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 41</b> <b>Hitne radnje i sprečavanje suđenja u odsustvu</b></p> <p>1. Kada je maloletnik zadržan, u zatvoru ili pritvoru, organi koji sprovode postupak imaju obavezu da hitno deluju.</p> <p>2. Maloletniku se ne može suditi u odsustvu.</p> <p>3. Kada postupaju u prisustvu maloletnika, a posebno pri njegovom ispitivanju, organi koji učestvuju u postupku dužni su da</p>

<p>marrin pjesë në procedurë janë të obliguara që të veprojnë me kujdes, duke marrë parasysh zhvillimin psikologjik, ndjeshmërinë dhe karakteristikat personale dhe nevojave të veçanta të të miturit në mënyrë që zbatimi i procedurës të mos ketë ndikim të kundërt në zhvillimin e tij.</p>	<p>in the proceedings are obliged to act carefully, taking into account the psychological development, sensitivity and the personal characteristics and special needs of the juvenile, so that the conduct of the proceedings does not have an adverse effect on his development.</p>	<p>postupaju pažljivo, uzimajući u obzir psihološki razvoj, osetljivost, lične karakteristike i posebne potrebe maloletnika, tako da vođenje postupka nema suprotno dejstvo na njegov razvoj.</p>
<p>4. I mitur duhet të informohet për të drejtat e tyre si ne vijim:</p>	<p>4. The juvenile must be informed of his rights as follows:</p>	<p>4. Maloletnik treba da bude informisan o svojim pravima po sledećem:</p>
<p>4.1. të drejtën për ta informuar mbajtësin e përgjegjësishë prindërore;</p>	<p>4.1. the right to inform the bearer of the parental responsibility;</p>	<p>4.1. pravo na informisanje nosioca roditeljskog prava;</p>
<p>4.2. të drejtën për t'u asistuar nga një avokat;</p>	<p>4.2. the right to be assisted by a defense counsel;</p>	<p>4.2. pravo na pomoć od strane jednog advokata;</p>
<p>4.3. të drejtën për mbrojtje të privatësisë;</p>	<p>4.3. the right to privacy protection;</p>	<p>4.3. pravo na zaštitu privatnosti;</p>
<p>4.4. të drejtën për të qenë i shoqëruar nga mbajtësi i përgjegjësishë prindërore gjatë fazave të procedurës, krahas atyre gjyqësore;</p>	<p>4.4. the right to be accompanied by the bearer of the parental responsibility during the stages of proceedings, alongside the court ones;</p>	<p>4.4. pravo da bude u pratnji nosioca roditeljskog prava tokom svih faza postupka, pored onih sudskih;</p>
<p>4.5. të drejtën për ndihmë ligjore;</p>	<p>4.5 The right to legal aid;</p>	<p>4.5. pravo na pravnu pomoć;</p>
<p>4.6. të drejtën për vlerësim individual;</p>	<p>4.6 the right to individual assessment;</p>	<p>4.6. pravo na individualnu procenu;</p>
<p>4.7. të drejtën për ekzaminim mjekësor;</p>	<p>4.7 The right to medical examination;</p>	<p>4.7. pravo na lekarsku kontrolu;</p>
<p>4.8. të drejtën për kufizimin e privimit të lirisë dhe në të drejtën e masave alternative, duke përfshirë të drejtën për</p>	<p>4.8 the right restraining of the deprivation of liberty and the right to alternative measures, including the</p>	<p>4.8. pravo da se ograniči pritvor i pravo alternativnih mera, uključujući i pravo na periodično preispitivanje pritvora;</p>

<p>shqyrtim periodik të paraburgimit;</p> <p>4.9. të drejtën për t'u shoqëruar nga mbajtësi i përgjegjësishë prindërore gjatë seancave gjyqësore;</p> <p>4.10. të drejtën për t'u paraqitur personalisht në gjykim;</p> <p>4.11. Të drejtën për mjete efektive; dhe</p> <p>4.12.të drejtën për trajtim specifik gjatë privimit nga liria</p> <p>5. Informacionet nga paragrafi 4 i këtij neni duhet të jepen me shkrim, me gojë, apo në të dy format, në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme dhe me kuptimin që informacioni i dhënë është regjistruar, duke përdorur procedurë regjistrimi.</p>	<p>right to periodic review of detention;</p> <p>4.9 the right to be accompanied by the bearer of parental responsibility during court proceedings;</p> <p>4.10.the right personally present himself in the trial;</p> <p>4.11.the right to effective means; and</p> <p>4.12.the right to specific treatment during deprivation of liberty</p> <p>5.Information from paragraph 4 of this Article shall be provided in written or verbal or both forms, in a simple and understandable language and with the understanding that the information provided is recorded, using a recording procedure.</p>	<p>4.9.pravo da bude u pratnji nosioca roditeljskog prava tokom sudskih rasprava;</p> <p>4.10. pravo da lično prisustvuje na suđenjima;</p> <p>4.11. pravo na efiksna pravna sredstva; i</p> <p>4.12. pravo na poseban pristup tokom trajanja pritvora;</p> <p>5.Informacije iz paragrafa 4 iz ovog člana, treba da se dostave u pisanoj formi, usmeno, ili u obe forme, jednostavnim i razumljivim jezikom i uz razumevanje da su date informacije registrovane, upotrebom procedure registracije.</p>
<p><b>Neni 42</b> <b>Mbrojtja e të miturit</b></p>	<p><b>Article 42</b> <b>Defending the Juvenile</b></p>	<p><b>Član 42</b> <b>Odbrana maloletnog</b></p>
<p>1. I mituri duhet të ketë mbrojtësin me rastin e marrjes për herë të parë në pyetje, si dhe gjatë tërë procedurës.</p> <p>2. Mbrojtësi i të miturit mundet me qenë vetëm avokati i cili është anëtar i Odës së Avokatëve të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Nëse vet i mituri ose përfaqësuesi i tij</p>	<p>1. The juvenile must have a defence counsel when examined for the first time, as well as during the entire proceedings.</p> <p>2. Only a defence counsel registered at the Kosovo Bar Association can represent a juvenile.</p> <p>3. In a case when the juvenile or his</p>	<p>1. Maloletnik mora imati svog branioca prilikom prvog ispitivanja, kao i tokom čitavog postupka.</p> <p>2. Maloletnika može da zatupa samo branilac koji je registrovan pri Advokatskoj komori Republike Kosovo.</p> <p>3. Ako sam maloletnik ili njegov zakonski</p>

<p>ligjor nuk marrin mbrojtës, mbrojtësin, sipas detyrës zyrtare, me shpenzime publike e cakton gjykata ose prokurori i shtetit për të mitur, apo organi tjetër i cili e zbaton procedurën, sipas rregullit nga radhët e avokatëve me specializim të veçantë nga fusha e mbrojtjes së drejtave të miturve sipas rënditjes nga regjistri i Odës së Avokatëve të Republikës së Kosovës.</p> <p>4. Para caktimit të mbrojtësit për të mitur me shpenzime publike sipas këtij neni, i mituri dhe prindërit të tij, prindërit adoptues, apo kujdestarit, duhet të plotësojnë një deklaratë duke cekur pasurinë e tyre dhe të deklarohen se nuk mund të përballojnë shpenzimet e mbrojtësit për të mitur.</p> <p>5. Mbrojtësi i caktuar sipas detyrës zyrtare në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni mbetet deri në përfundimin e procedurës përveç nëse dalin rrethana objektive jashtë kontrollit të mbrojtësit për të mitur të cilat do ta kërkonin ndërrimin e përfaqësimit juridik të të miturit apo derisa i mituri ose përfaqësuesi i tij ligjor vetë nuk e zgjedhin mbrojtësin.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 43</b></p>	<p>legal representative does not engage a defence counsel, the court or juvenile state prosecutor, or other authority conducting the proceedings shall appoint ex officio a defence counsel at public expense, based on the rule of more specific defence counsels specialized in the field of protection of juveniles' rights according to the ordering from the register of Kosovo Bar Association.</p> <p>4. Prior to appointing the defence counsel with public expenses based on this Article, the juvenile and his parents, adoptive parents or the guardian shall fill in a statement stating their property and stating that they are not able to face with the expenses of the juvenile defence counsel.</p> <p>5. The defence counsel appointed ex officio in accordance with paragraph 3 of this Article shall remain until the completion of the proceedings, unless objective circumstances arise that are beyond the control of the juvenile defence counsel that would require change of the legal representation of the juvenile, or until the juvenile or his legal representative does not engage a defence counsel himself.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 43</b></p>	<p>zastupnik ne angazuju branioca, onda branioca po službenoj dužnosti, o državnom trošku određuje sud, odnosno državni tužilac za maloletnike ili drugi organ koji vodi postupak, po pravilu iz reda advokata koji su specijalizovani u posebnoj oblasti zaštite prava maloletnika iz registra Advokatske komore Republike Kosovo.</p> <p>4. Pre dodeljivanja branioca za maloletnike u javnom trošku prema ovom Članu, maloletnik i roditelji, njegovi roditelji usvojitelji, ili staratelji moraju ispuniti deklaraciju navodeći svoju imovinu i izjaviti da ne mogu priuštiti branioca za maloletnika.</p> <p>5. Branilac koji je imenovan po službenoj dužnosti u skladu sa paragrafom 3 iz ovog člana ostaje do kraja postupka, osim objektivnih okolnosti nastalih izvan kontrole maloletnih branitelja koji će zahtevati promene u zastupanju maloletnika ili dok maloletnik ili njegov pravni zastupnik nisu sami izabrali svog branioca.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 43</b></p>
--	---	--

<b>Shoqërimi i të miturit</b>	<b>Accompanying the Juvenile</b>	<b>Pratnja maloletnika</b>
<p>1. Prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari kanë të drejtë ta shoqërojnë të miturin në të gjitha procedurat dhe nga ata mund të kërkohet që të marrin pjesë nëse kjo është në interes të të miturit. Gjykata mund ta përjashtojë prindin, prindin adoptues ose kujdestarin nga pjesëmarrja në procedurë nëse përjashtimi i tillë është në interesin më të mirë të të miturit.</p> <p>2. Kur prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari i të miturit nuk e kryejnë detyrën e tyre prindore, gjykata mund të caktojë një (1) kujdestar të përkohshëm për të miturin.</p> <p>3. Gjykatat mbajnë evidencë të përgatitur nga Qendra për Punë Sociale, për punëtorët socialë, arsimtarët, pedagogët ose specialistët vullnetarë nga mesi i të cilëve caktohet kujdestari i përkohshëm në rastet nga paragrafi 2 i këtij neni.</p>	<p>1. The parents, adoptive parents or guardian shall be entitled to accompany the juvenile in all proceedings and may be required to participate if it is in the best interest of the juvenile. The court may exclude a parent, adoptive parent or guardian from participation in proceedings if such exclusion is in the best interest of the juvenile.</p> <p>2. When the parents, adoptive parents or guardian of the juvenile do not exercise their parental duties, the court may nominate one (1) temporary guardian for the juvenile.</p> <p>3. The courts shall keep a record, prepared by the Centre for Social Work, of social workers, teachers, pedagogues, or volunteer specialists, from which the temporary guardian shall be nominated in cases under paragraph 2 of this Article.</p>	<p>1. Roditelji, usvojitelji ili staratelj imaju pravo da budu uz maloletnika u svim postupcima i od njih može da bude zahtevano da učestvuju ako je to u najboljem interesu maloletnika. Sudija za maloletnike može da isključi roditelja, usvojitelja ili staratelja iz učešća u postupku ako je takvo izuzeće u najboljem interesu maloletnika.</p> <p>2. Kada roditelji, usvojitelj ili staratelj maloletnika ne izvršavaju svoje roditeljske obaveze, sud može maloletniku da postavi jednog (1) privremenog staratelja.</p> <p>3. Sudovi vode evidenciju pripremljenu od Centra za socijalni rad, o socijalnim radnicima, nastavnicima, pedagogima ili dobrovoljnim stručnjacima iz čijih redova se postavlja privremeni staratelj u slučajevima iz paragrafa 2 iz ovog Člana.</p>
<p><b>Neni 44</b> <b>Detyrimi për të dëshmuar</b></p>	<p><b>Article 44</b> <b>Obligation to Testify</b></p>	<p><b>Član 44</b> <b>Obaveza svedočenja</b></p>
<p>Askush nuk mund të përjashtohet nga detyra për të dëshmuar lidhur me rrethanat e nevojshme për vlerësimin e zhvillimit psikologjik të të miturit ose për njohjen e personalitetit të tij dhe të kushteve në të cilat jeton ai.</p>	<p>No one may be exempted from the duty to testify concerning the circumstances necessary for the evaluation of the psychological development of the juvenile and for a familiarity with his personality and the conditions in which</p>	<p>Nijedno lice ne može da bude oslobođeno dužnosti da svedoči u vezi sa okolnostima potrebnim za procenjivanje psihološkog razvoja maloletnika ili upoznavanje njegove ličnosti i uslova u kojima on živi.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 45</b> <b>Veçimi i procedurës</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 45</b> <b>Severing of Procedure</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 45</b> <b>Izdvajanje postupka</b></p>
<p>1. Kur i mituri ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale me një të rritur, procedura gjyqësore ndaj të miturit ndahet dhe zbatohet sipas dispozitave të këtij kodi.</p> <p>2. Përjashtimisht, procedura ndaj të miturit mund të bashkohet me procedurën ndaj të rriturit dhe zbatohet në pajtim me dispozitat e përgjithshme të Kodit të Procedurës Penale, vetëm nëse bashkimi i procedurës është i nevojshëm për sqarim gjithëpërfshirës të rastit. Kolegji për të mitur në fazat e procedurës para shqyrtimit gjyqësor ose trupi gjykues për të mitur në shqyrtim gjyqësor, merr vendim lidhur me këtë në bazë të propozimit të arsyeshëm të prokurorit të shtetit për të mitur ose mbrojtësit. Pas pranimit të vendimit, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në gjykatën e shkallës së dytë brenda afatit prej tri ditësh.</p> <p>3. Kur procedura e bashkuar zbatohet ndaj të miturit dhe kryerësit madhor, dispozitat e nenit 41- 44, neni 46, 47, 48 paragrafët 1 dhe 3, neni 61 - 64 dhe neni 67 i këtij Kodi zbatohen gjithmonë lidhur me të miturin në rastet kur çështjet që kanë të bëjnë me të</p>	<p>he lives.</p> <p>1. When a juvenile has participated in the commission of a criminal offence with an adult, the court proceedings against the juvenile shall be severed and conducted according to the provisions of the present Code.</p> <p>2. Exceptionally, the proceedings against the juvenile can be joined to the proceedings against an adult and can be conducted in accordance with the general provisions of the Criminal Procedure Code of Kosovo, only if joining of the proceedings is essential for a comprehensive clarification of the case. A juvenile collegiate during the stages of main trial or the juvenile judicial panel in the main trial shall issue a ruling on this based on the reasoned motion of the juvenile state prosecutor or the defence counsel. Upon the receipt of the decision, the unsatisfied party shall be entitled to file a complaint with the court of second instance within a timeframe of three days.</p> <p>3. When joint proceedings are conducted against a juvenile and an adult perpetrator, the provisions of Article 41-44, Article 46, 47, 48 paragraphs 1 and 3, Articles 61 - 64 and Article 67 of the present Code shall always be applied in</p>	<p>1. Kada je maloletnik učestvovao u izvršenju krivičnog dela sa punoletnim licem, postupak protiv maloletnika biva razdvojen i vodi se prema odredbama ovog Zakonika.</p> <p>2. Izuzetno, postupak protiv maloletnika može da se spoji sa postupkom protiv punoletnog lica i može da bude vođen u skladu sa opštim odredbama Zakonika o krivičnom postupku Kosova, samo ako je spajanje postupka od suštinske važnosti za razjašnjavanje slučaja. Sudsko veće za maloletnike nadležnog suda donosi rešenje o ovome na osnovu opravdanog predloga tužioca ili branioca. Stranke mogu da uloze žalbu protiv rešenja drugostepnom sudu, u roku od tri (3) dana od prijema rešenja. Posle dobijanja odluke, nezadovoljna strana ima pravo žalbe pri drugostepenom sudu u roku od tri dana..</p> <p>3. Kada se vodi zajednički postupak protiv maloletnog i punoletnog izvršioca, odrebe Člana 41, Člana 46, 47, Člana 48 paragraf 1 i 3, Članova 61-64 i Člana 67 ovog Zakonika, uvek se primenjuju na maloletnika u slučajevima kada pitanja koja</p>

<p>miturin sqarohen në procedurë dhe nenet 72 -74 të këtij Kodi zbatohen gjithmonë lidhur me të miturin, ndërsa dispozitat tjera të këtij Kodi zbatohen nëse aplikimi i tyre nuk është në kundërshtim me zbatimin e procedurës së përbashkët.</p>	<p>regard to the juvenile when questions relating to the juvenile are being clarified in a the proceeding and Articles 72- 74 of the present Code shall always be applied in regard to the juvenile, while other provisions of the present Code shall be applied if their application is not in conflict with the conduct of joint proceedings.</p>	<p>se odnose na maloletnika se razjašnjavaju na sudskom pretresu i članovi 72, i 74 iz ovog Zakonika se uvek primenjuju u vezi maloletnika, dok ostale odredbe ovog Zakonika primenjuju se ako njihova primena nije u suprotnosti sa vođenjem zajedničkog postupka.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 46</b> <b>Njoftimi për fillimin dhe rrjedhën e procedurës</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 46</b> <b>Notification on Initiation and Course of Proceedings</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 46</b> <b>Obaveštenje o pokretanju i toku postupka</b></p>
<p>1. Në procedurë ndaj të miturve, pavarësisht nga kompetencat e parashikuara qartë në dispozitat e këtij Kodi, organi i kujdestarisë dhe shërbimi sprovues njoftohet për rrjedhën e procedurës, të bëjë propozime dhe të paraqesë fakte e prova të rëndësishme për marrjen e vendimit të drejtë.</p>	<p>1. In proceedings against juveniles, irrespective of the powers which have been explicitly provided for in the provisions of the present Code, the Guardianship Authority and Probation Service are entitled to be notified of the course of the proceedings and to submit motions and state facts and evidence which are important for rendering a correct decision.</p>	<p>1. U postupku protiv maloletnika, nezavisno od ovlašćenja jasno predviđenih u odredbama ovog Zakonika, Organ starateljstva obaveštava se o toku postupka, da podnosi predloge i iznosi činjenice i dokaze koji su važni za donošenje pravilne odluke.</p>
<p>2. Prokurori i shtetit për të mitur e njofton organin kompetent të kujdestarisë dhe shërbimit sprovues kurdo që fillon procedura kundër të miturit.</p>	<p>2. The juvenile state prosecutor shall notify the competent Guardianship Authority and Probation Service whenever proceedings against a juvenile are initiated.</p>	<p>2. Državni tužilac za maloletne obaveštava nadležni Organ starateljstva i probacionu službu uvek kada je pokrenut postupak protiv maloletnika.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 47</b> <b>Ftesa</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 47</b> <b>Invitation</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 47</b> <b>Pozivnica</b></p>
<p>1. Ftesa per pjesëmarrjen e te miturit ne procedure i dorezohet personalisht dhe</p>	<p>1. The juvenile shall be summoned in person and through his parent, adoptive</p>	<p>1. Maloletnik se poziva u sud lično, preko roditelja, usvojitelja ili njegovog stratelja.</p>



<p>përmes prindit, prindit adoptues ose kujdestarit të tij.</p> <p>2. Të miturit i dorëzohen vendimet dhe dokumentet e tjera të shkruara në pajtim me dispozitat e Kodit të procedurës penale, duke përjashtuar dispozitat e Kodit të procedurës penale për shpalljen e dokumenteve, duke i ekspozuar në tabelën e shpalljeve të gjykatës.</p>	<p>parent or guardian to participate in the proceedings. .</p> <p>2. The service of decisions and other written documents on the juvenile shall be carried out in accordance with the provisions of the Criminal Procedure Code on announcing of documents by displaying on the bulletin board of the court.</p>	<p>2. Maloletniku se predaju rešenja i ostala pisana dokumenta u skladu sa Zakonikom o krivičnom postupku. Ipak dokumenta se ne dostavljaju maloletniku u vidu izlaganja na na oglasnoj tabeli suda, pa se tako ne sprovode odredbe Zakonika o krivičnom postupku za proglašenje dokumenata, objavljujući ih na tabeli za objave u sudu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 48 Konfidencialiteti</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 48 Confidentiality</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 48 Poverljivost</b></p>
<p>1. Të gjitha procedurat në të cilat janë të përfshirë të miturit janë konfidenciale. Asnjë incizim i procedurës, duke përfshirë edhe audio dhe video incizimin, nuk mund të bëhet publik pa autorizimin e gjykatës.</p> <p>2. Vetëm pjesa e vendimit të marrë gjatë procedurës që autorizohet për publikim bëhet publike.</p> <p>3. Kur pjesa e autorizuar e incizimit të procedurës ose e vendimit bëhet publike nuk zbulohen të dhënat personale që mund të shfrytëzohen për identifikimin e të miturit.</p> <p>4. Dispozitat e këtij neni zbatohen në procedurat ku përfshihen madhorët që gjykohen për vepra penale që i kanë kryer si të mitur.</p>	<p>1. All proceedings involving juveniles shall be confidential. No recording of the proceedings, including audio and video recording, may be made public without the authorization of the court.</p> <p>2. Only the part of the decision rendered in the proceedings authorized for publication shall be made public.</p> <p>3. When an authorized part of recorded proceedings or of the decision is made public, personal data that can be used to identify the juvenile shall not be revealed.</p> <p>4. The provisions of this article shall apply to proceedings involving adults tried for criminal offences committed as juveniles.</p>	<p>1. Svi postupci koji uključuju maloletnika su poverljivi. Nikakvo snimanje postupka, uključujući tonsko ili video snimanje, ne sme biti objavljeno bez odobrenja suda.</p> <p>2. Samo deo presude donete u toku postupka koji je odobren za objavljivanje sme da bude objavljen.</p> <p>3. Kada je odobreni deo snimanog postupka ili odluke objavljen, lični podaci koji mogu da budu iskorišćeni za identifikaciju maloletnika ne smeju da budu otkriveni.</p> <p>4. Odredbe ovog člana primenjuju se u postupcima koji obuhvataju punoletno lice kome se sudi za krivična dela koja je izvršio kao maloletnik.</p>

<p><b>KAPITULLI II - TRUPI GJYKUES PËR TË MITUR</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 49 Përbërja</b></p> <p>1. Në shkallën e parë gjyqtari për të mitur gjykon për veprat penale për të cilat si dënim kryesor është i paraparë dënimi me gjobë ose dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vite.</p> <p>2. Në shkallën e parë trupi gjykues për të mitur i përbërë nga tre gjyqtar prej të cilëve kryetari i trupit gjykues është gjyqtar për të mitur, gjykon për veprat penale për të cilat është i parapaë dënimi me burgim mbi dhjetë (10) vite ose dënimi më i rënd.</p> <p>3. Në shkallën e dytë gjykon kolegji për të mitur i përbër prej tre gjyqtarve prej të cilëve gjyqtari referues është gjyqtari për të mitur. Në shkallën e tretë si dhe sipas mjeteve të jashtzakonshme juridike dhe në rastet tjera të përcaktuara me këtë Kod gjykon kolegji për të mitur i përbërë nga tre gjyqtar prej të cilëve kryetari i kolegjit është gjyqtar për të mitur.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 50</b></p>	<p><b>CHAPTER II - JUVENILE PANEL</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 49 Composition</b></p> <p>1. The juvenile judge in the first instance shall adjudicate for criminal offences for which the main foreseen punishment is a fine or imprisonment up to ten (10) years.</p> <p>2. A juvenile panel in the court of first instance composed of three judges, of which the presiding judge of juvenile panel is a juvenile judge, shall adjudicate criminal offences for which the foreseen punishment is imprisonment over ten (10) years or more serious punishment.</p> <p>3. A juvenile collegiate in the second instance composed of three judges, of which the referring judge is a juvenile judge. In the third instance and based on extraordinary legal means and other three judges of which the president of the collegiate is a juvenile judge.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 50</b></p>	<p><b>POGLAVLJE II - SUDSKO VEĆE ZA MALOLETNE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 49 Sastav</b></p> <p>1. Na prvom stepenu, sudija za maloletnike sudi za krivična dela za koje je kao glavna kazna predviđena novčana kazna ili kazna zatvorom do deset (10) godina.</p> <p>2. Na prvom stepenu, sudsko veće za maloletnike sastavljeno od troje sudija od kojih je predsedavajući sudskog veća upravo sudija za maloletnike, sudeći za krivična dela za koje je predviđena kazna zatvora više od deset (10) godina ili teža kazna.</p> <p>3. Na drugom stepenu, sudi kolegijum sudija za maloletnike sastavljen od troje sudija od kojih je sudija izvestailac upravo sudija za maloletnike. Na trećem stepenu i na osnovu vanrednih pravnih lekova i drugim slučajevima predviđenih ovim Zakonikom postupak vodi kolegijum za maloletnike koji se sastoji od tri sudije od kojih je predsedavajući kolegijuma upravo sudija za maloletnike.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 50</b></p>
--	--	---

<b>Pezullimi i ndjekjes</b>	<b>Suspension of Prosecution</b>	<b>Obustava postupka</b>
<p>Prokurori i shtetit për të mitur mund të pezullojë ndjekjen e veprës penale dhe të shqiptojë masën e diversitetit nëse janë plotësuar kushtet nga neni 21 i këtij Kodi. Para vendosjes për masën e diversitetit, prokurori e thërret të miturin, prindin e tij, prindërit adoptues ose kujdestarin dhe mbrojtësin.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 51</b> <b>Kompetenca e gjykatës së shkallës së dytë</b></p> <p>1. Gjykata e shkallës së dytë është kompetente:</p> <p>1.1. të vendosë për ankesën kundër vendimit të gjyqtarit për të mitur ose trupit gjykues për të mitur të shqiptuar në shkallë të parë;</p> <p>1.2. të vendosë për ankesën kundër vendimit të prokurorit të shtetit për të mitur dhe</p> <p>1.3. në rastet e tjera të veprojë ashtu siç parashihet me ligj.</p>	<p>The juvenile state prosecutor may suspend the prosecution of a criminal offence and impose a diversion measure if the conditions under Article 21 of this Code are fulfilled. Before deciding on a diversion measure, the prosecutor shall summon the juvenile, his parent, adoptive parents or guardian and defence counsel.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 51</b> <b>Jurisdiction of the Court of Second Instance</b></p> <p>1. The court of second instance shall have jurisdiction:</p> <p>1.1. to decide on an appeal against a decision of the juvenile judge or juvenile panel rendered at first instance;</p> <p>1.2. to decide on an appeal against a decision of the juvenile state prosecutor; and</p> <p>1.3. in other cases, to act as provided for by law.</p>	<p>Tužilac može da obustavi gonjenje krivičnog dela i izrekne meru diverziteta ako su se ispunili uslovi iz člana 21 ovog Zakonika. Pre odlučivanja o meri odvracanja, tužilac poziva maloletnika, njegove roditelje, usvojitelje ili staratelja i branioca.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 51</b> <b>Nadležnosti drugostepenog suda</b></p> <p>1. Drugostepeni sud je nadležan:</p> <p>1.1. da odlučuje o žalbi protiv odluke sudije za maloletnike ili sudskog veća za maloletnike izrečene u prvom stepenu;</p> <p>1.2. da odlučuje o žalbi protiv odluke državnog tužioca za maloletnike; i</p> <p>1.3. u drugim slučajevima postupa onako kako je to predviđeno zakonikom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 52</b> <b>Kompetenca teritoriale</b></p> <p>1. Gjykata në territorin e së cilës është adresa e përhershme e vendbanimit të të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 52</b> <b>Territorial Jurisdiction</b></p> <p>1. As a rule, the court within whose territory a juvenile has a permanent</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 52</b> <b>Teritorijalna nadležnost</b></p> <p>1. Po pravilu, sud na čijoj teritoriji maloletnik ima stalno prebivalište</p>

<p>miturit, sipas rregullit ka kompetencë territoriale për procedurë kundër të miturit.</p> <p>2. Nëse i mituri nuk ka adresë të përhershme apo nëse adresa e tij nuk dihet, gjykata në territorin e së cilës aktualisht ndodhet vendbanimi i të miturit ka kompetencë territoriale.</p> <p>3. Procedura mund të zbatohet në gjykatën në territorin e së cilës aktualisht ndodhet vendbanimi i të miturit, edhe kur ai ka vendbanim të përhershëm, ose në gjykatën në territorin e së cilës është kryer vepra penale nëse është e qartë që procedura do të zbatohet më lehtë në atë gjykatë.</p> <p>4. Për veprat penale të paraparë në nenin 109, sipas rregullit, gjykata në territorin e së cilës e ka vendbanimin e përhershëm pala e dëmtuar ka kompetencë territoriale për procedurën për veprat penale të kryera ndaj fëmijës, ndërsa procedura mund të zbatohet në gjykatën në territorin e së cilës është kryer vepra penale kur procedura pranë asaj gjykate zbatohet më lehtë.</p> <p><b>KAPITULLI III - PROCEDURA PËRGATITORE</b></p> <p><b>Neni 53</b></p>	<p>residence shall have territorial jurisdiction for proceedings against the juvenile.</p> <p>2. If a juvenile does not have a permanent residence or if it is unknown, the court within whose territory the juvenile has current residence shall have territorial jurisdiction.</p> <p>3. Proceedings may be conducted before the court within whose territory a juvenile has current residence, even though he has a permanent residence, or before the court within whose territory the criminal offence has been committed, if it is clear that the proceedings will be conducted more easily before that court.</p> <p>4. For criminal proceedings foreseen by Article 109, according to the rule, the court in which territory the injured party has his permanent residence shall have the territorial competence for the criminal proceedings committed against the child, whereas the proceedings may be carried out in the court in which territory the criminal offence was conducted, when the proceedings with that court is easier implemented.</p> <p><b>CHAPTER III - PREPARATORY PROCEEDINGS</b></p> <p><b>Article 53</b></p>	<p>teritorijalno je nadležan za vođenje postupka protiv maloletnika.</p> <p>2. Ako maloletnik nema stalnu adresu ili je adresa nepoznata, teritorijalno je nadležan sud na čijoj teritoriji maloletnik ima trenutno boravište.</p> <p>3. Postupak može da bude vođen pred sudom na čijoj teritoriji maloletnik ima trenutno boravište iako on ima stalno prebivalište, ili pred sudom na čijoj teritoriji je izvršeno krivično delo, ako je očigledno da će pred tim sudom postupak biti vođen mnogo lakše.</p> <p>4. Za krivična dela predviđena u članu 109. po pravilu, sud na čijem području je stalno prebivalište oštećene strane je mesno nadležan za pokretanje postupka za krivična dela izvršena protiv deteta, a postupak može da se primeni pri sudu na teritoriji gde je zločin počinjen ako se sudski postupak lakše primenjuje pri tom sudu.</p> <p><b>POGLAVLJE III - PRIPREMNI POSTUPAK</b></p> <p><b>Član 53</b></p>
---	--	--

<b>Fillimi i procedurës pregaditore</b>	<b>Initiation of Preparatory Proceedings</b>	<b>Pokretanje pripremnog postupka</b>
<p>1. Prokurori i shtetit për të mitur mund të fillon procedurën përgatitore ndaj të miturit të caktuar në bazë të kallëzimit penal të policisë, kallëzimit penal nga persona të tjerë ose nga burime të tjera nëse ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer vepër penale.</p> <p>2. Për veprat penale të dënueshme me burgim prej më pak se tre (3) vjet ose me gjobë, prokurori i shtetit për të mitur mund të vendosë të mos fillojë procedurën përgatitore edhe pse ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer vepër penale, nëse prokurori i shtetit për të mitur mendon se nuk do të ishte e përshtatshme të zbatohet procedura kundër të miturit për shkak të natyrës së veprës penale, të rrethanave në të cilat është kryer ajo, mungesës së dëmit të rëndë ose të pasojave për të dëmtuarin, si edhe të kaluarës së të miturit dhe të karakteristikave të tij personale.</p> <p>3. Kur ndaj të miturit ekzekutohet dënimi ose masa, prokurori i shtetit për të mitur mund të vendosë të mos fillojë procedurën përgatitore për një vepër tjetër penale të kryer nga i mituri, nëse duke pasur parasysh peshën e asaj vepre penale, si dhe dënimin a masën e cila është duke u ekzekutuar, zbatimi i procedurës dhe shqiptimi i dënimit</p>	<p>1. The juvenile state prosecutor may initiate preparatory proceedings on a juvenile determined based on a criminal report by police, criminal charge by other persons or other sources if there is reasonable suspicion that the juvenile committed the criminal offence.</p> <p>2. For criminal offences punishable by imprisonment of less than three (3) years or a fine, the juvenile state prosecutor may decide not to initiate preparatory proceedings, even though there is a reasonable suspicion that the juvenile committed the criminal offence, if the juvenile state prosecutor considers that it would not be appropriate to conduct the proceedings against the juvenile in view of the nature of the criminal offence, the circumstances under which it was committed, the absence of serious damage or consequences for the victim, as well as the juvenile's past history and personal characteristics.</p> <p>3. When a punishment or measure is being executed against a juvenile, the juvenile state prosecutor may decide not to initiate preparatory proceedings for another criminal offence of the juvenile, if, having regard to the seriousness of that criminal offence as well as to the punishment or measure which is being</p>	<p>1. Tužilac pokreće priprejni postupak protiv određenog maloletnika na osnovu policijske krivične prijave, krivične prijave drugih lica ili iz drugih izvora ako postoji opravdana sumnja da je maloletnik izvršio krivično delo.</p> <p>2. Za krivična dela kažnjiva kaznom zatvora kraćom od tri (3) godine ili novčanom kaznom, tužilac može da odluči da ne pokrene priprejni postupak iako postoji osnovana sumnja da je maloletnik izvršio krivično delo, ako tužilac smatra da nebi bilo odgovarajuće da bude vođen postupak protiv maloletnika zbog prirode krivičnog dela, okolnosti pod kojima je izvršeno, odsustva ozbiljne štete ili posledica za oštećenog, kao i ličnih karakteristika i ranijeg ponašanja maloletnika.</p> <p>3. Kada se izvršava kazna ili mera protiv maloletnika, tužilac može da odluči da ne pokrene priprejni postupak za drugo krivično delo koje je izvršio malolatnik ako, imajući u vidu ozbiljnost tog krivičnog dela kao i kaznu i meru koja se izvršava, vođenje postupka i izricanje kazne ili mere ne bi služilo bilo kojoj svrsi.</p>

<p>ose i masës për veprën penale nuk do t'i shërbente ndonjë qëllimi.</p> <p>4. Nëse prokurori i shtetit për të mitur vendos të mos fillojë procedurën përgatitore, ai e njofton organin e kujdestarisë, policinë dhe palën e dëmtuar kur rasti është inicuar nga policia.</p> <p>5. Për t'i vërtetuar rrethanat nga paragrafi 1 të këtij neni, prokurori i shtetit mund të kërkojë që shërbimi sprovues ta bëjë një anketë sociale të parashikuar në nenin 13 të këtij Kodi. Nëse është e nevojshme, prokurori i shtetit për të mitur mund ta thirr prindin, prindin adoptues ose kujdestarin e të miturit, si edhe personat dhe institucionet e tjera dhe palën e dëmtuar.</p> <p>6. Nëse për ndonjë arsye nuk është e mundur që anketa sociale sipas paragrafit 5 të këtij neni të përfundohet para se të merret vendimi për përshtatshmërinë e fillimit të procedurës përgatitore, prokurori i shtetit për të mitur i siguron informatat e nevojshme sipas nenit 13 të këtij Kodi dhe mund të konsultohet me shërbimin sprovues për vendimin e tij.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 54</b></p>	<p>executed, the conduct of proceedings and the imposition of a punishment or measure for that criminal offence would not serve any purpose.</p> <p>4. If the juvenile state prosecutor decides not to initiate preparatory proceedings, he shall notify the Guardianship Authority, the police and the injured party when the case is initiated by the police.</p> <p>5. In order to ascertain the circumstances under paragraph 1 of this Article, the state prosecutor may request that the Probation Service conduct the social inquiry provided for in Article 13 of the present Code. If it is necessary, the juvenile state prosecutor may summon the parent, adoptive parent or guardian of the juvenile, as well as other persons and institutions and the injured party.</p> <p>6. If, for any reason, it is not possible to have the social inquiry under paragraph 5 of this Article completed before taking a decision on the appropriateness of the initiation of preparatory proceedings, the juvenile state prosecutor shall secure the necessary information under Article 13 of the present Code and may consult with the Probation Service about his decision.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 54</b></p>	<p>4. Ako tužilac odluči da ne pokrene pripremljeni postupak, on obaveštava organ starateljstva, policiju i oštećenu stranu kada je slučaj iniciran od strane policije.</p> <p>5. U cilju utvrđivanja okolnosti iz paragrafa 1 ovog člana, državni tužilac može da zahteva da Probaciona služba sprovede socijalnu anketu predviđenu iz člana 13 ovog Zakonika. Ako je potrebno, tužilac može da pozove roditelja, usvojitelja ili staratelja maloletnika kao i ostala lica i institucije i oštećenu stranu.</p> <p>6. Ako iz bilo kojeg razloga nije moguće da socialna anketa iz paragrafa 5 iz ovog člana bude obavljena pre donošenja odluke o podobnosti pokretanja pripremljenog postupka, tužilac obezbeđuje potrebne informacije iz člana 13 ovog Zakonika, te može da se konsultuje sa Probacionom službom o svojoj odluci.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 54</b></p>
---	--	--

<b>Aktvendimi për fillimin e procedurës pregaditore</b>	<b>Ruling for Initiation of Preparatory Proceedings</b>	<b>Rešenje o pokretanju pripremnog postupka</b>
<p>1. Procedura përgatitore fillohet me aktvendim të prokurorit të shtetit për të mitur. Në aktvendim përcaktohet i mituri ndaj të cilit zbatohet procedura përgatitore, koha e fillimit të procedurës përgatitore, përshkrimi i veprës që përcakton elementet e veprës penale, emërtimi ligjor i veprës penale, rrethanat dhe faktet që arsyetojnë dyshimin e bazuar për veprën penale, provat dhe informatat e mbledhura dhe raporti për ndonjë dënim ose masë të shqiptuar më parë ndaj të miturit. Një kopje e vulosur e aktvendimit mbi procedurën përgatitore i dërgohet pa vonesë gjyqtarit për të mitur.</p> <p>2. Dispozitat e Kodit të procedurës penale zbatohen përshtatshmërisht në procedurën përgatitore.</p>	<p>1. Preparatory proceedings shall be initiated by a ruling of the juvenile state prosecutor. The ruling shall specify the juvenile against whom the preparatory proceedings will be conducted, the time of the initiation of the preparatory proceedings, a description of the act which specifies the elements of the criminal offence, the legal name of the criminal offence, the circumstances and facts warranting the reasonable suspicion of a criminal offence, evidence and information already collected and a report on any measure or punishment previously imposed on the juvenile. A stamped copy of the ruling on the preparatory proceedings shall be sent without delay to the juvenile judge.</p> <p>2. Provisions of the Criminal Procedure Code of Kosovo shall apply mutatis mutandis to the conduct of preparatory proceedings.</p>	<p>1. Pripremni postupak pokreće se rešenjem tužioca. Rešenjem se utvrđuje maloletnik protiv kojeg se vodi pripremni postupak, vreme pokretanja pripremnog postupka, opis dela u kojem su navedeni elementi krivičnog dela, pravni naziv krivičnog dela, okolnosti i činjenice koje potvrđuju opravdanu sumnju za izvršenje krivičnog dela, dokazi i informacije koji su već prikupljeni i izveštaj o bilo kojoj meri ili kazni koja je ranije izrečena maloletniku. Overena kopija rešenja o pripremnom postupku dostavlja se sudiji za maloletnike bez odlaganja.</p> <p>2. Odredbe Zakonika o krivičnom postupku se sprovode u skladu sa pripremnim postupkom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 55</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Caktimi i ekspertit të shëndetit mendor dhe raporti parandëshkues</b></p> <p>1. Gjykata cakton ekspert përkatës të shëndetit mendor kur është e nevojshme të vërtetohet gjendja e shëndetit mendor të të miturit qoftë në kohën e kryerjes së veprës</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 55</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Appointing a mental health expert and presentence report</b></p> <p>1. The court shall appoint an appropriate mental health expert when it is necessary to establish the state of the juvenile's mental health either at the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 55</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Određivanje stručnjaka za mentalno zdravlje i predkazneni izveštaj</b></p> <p>1. Sudija za malolatnike određuje odgovarajuće stručnjake za mentalno zdravlje, kada je to potrebno radi utvrđivanja mentalnog zdravlja maloletnika,</p>

